



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.10

Datë 20 shkurt 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.19, datë 13.2.2006	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e një anëtari të Gjykatës së Lartë.....	207
Vendim i Kuvendit nr.20, datë 13.2.2006	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e një anëtari të Gjykatës së Lartë.....	207
Dekret nr.4765 datë 8.2.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	208
Dekret nr.4777 datë 14.2.2006	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Fajza, qarku Kukës.....	209
Dekret nr.4784 datë 19.2.2006	Për emërim ambasadori.....	209
Vendim i KM nr.57, datë 1.2.2006	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të një pjese të godinës së ish-ISP-së, nr.1, në Tiranë, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, për Universitetin Politeknik të Tiranës.....	210

Vendim i KM nr.63, datë 1.2.2006	Për listën e mallrave, të zgjedhura për llogaritjen e indeksit dhe përcaktimin e mënyrës e të datës së indeksimit të pensioneve.....	212
Vendim i KM nr.64, datë 1.2.2006	Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të një trualli, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.....	214
Vendim i KM nr.69, datë 27.1.2006	Për mënyrën e llogaritjes së trajtimit të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruës të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension	214
Vendim i KM nr.76, datë 8.2.2006	Për lirimimin dhe caktimin e administratorëve të shoqërive huamarrëse, në administrim.....	215
Vendim i KM nr.77, datë 8.2.2006	Për lejimin e institucioneve buxhetore dhe të ndërmarrjeve e shoqërive me kapital shtetëror të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.....	216
Vendim i AMS nr.5, datë 3.2.2006	Për miratimin e ndryshimit të emrit të shoqërisë së sigurimeve “Dukagjini AL” sh.a.....	216
Vendim i AMS nr.6, datë 3.2.2006	Për miratimin e ushtrimit të veprimtarisë risiguruese të shoqërisë së sigurimit “Sigal” sh.a.....	217
	Shpallje kërkesë për zhvlerësim me interes publik.....	217
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Faik Sanxhaktari.....	219

VENDIM
Nr. 19, datë 13.2.2006

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË GJYKATËS SË
LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.4730, datë 15.12.2005,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Jepet pëlqimi për emërimin e zotit Fatos Lulo në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 20, datë 13.2.2006

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË GJYKATËS SË
LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.4732, datë 15.12.2005,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Jepet pëlqimi për emërimin e zotit Gani Dizdari në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr. 4765, datë 8.2.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|---------------------------------------|
| 1. Leonard Edmond Kadilli | 30. Aleksandër Jani Isaia |
| 2. Vojsava Selam Hofstaller (Shtylla) | 31. Elda Remzi Hamataj (Bylyku) |
| 3. Sali Selman Peca | 32. Shemsie Jonuz Zabel (Nishori) |
| 4. Leonora Milo Peca (Muho) | 33. Vera Ahmet Brem (Rexhepaj) |
| 5. Florian Sali Peca | 34. Albana Mane Koraqe (Duro) |
| 6. Elis Sali Peca | 35. Klaus Artan Koraqe |
| 7. Lavdimir Bashkim Puca | 36. Ylli Artan Koraqe |
| 8. Mhill Gjok Tusha | 37. Edlira Mustafa Azizi (Lloshi) |
| 9. Nini Selami Çela | 38. Mirela Shaban Hoxha (Baroni) |
| 10. Ortenca Beqir Kolloshina | 39. Alessia Lulëzim Hoxha |
| 11. Stevi Pëllumb Shahini | 40. Vjollca Zeqir Zielinski (Mulgeci) |
| 12. Zeqir Rexh Matmuja | 41. Blendi Emërlla Çitozi |
| 13. Hume Sali Matmuja (Lekica) | 42. Gramoz Muharrem Kollidani |
| 14. Fadilja Zeqir Matmuja | 43. Agron Remzi Fisniku |
| 15. Rexh Zeqir Matmuja | 44. Herla Agron Fisniku |
| 16. Vllaznim Zeqir Matmuja | 45. Xhemile Neshat Fisniku (Fetishi) |
| 17. Rolandi Andon Qafzezi | 46. Sali Hamit Allmuça |
| 18. Sonny Rolandi Qafzezi | 47. Ilir Hiqmet Ndreu |
| 19. Joelle Rolandi Qafzezi | 48. Adem Ismet Cara |
| 20. Silvana Teki Qafzezi (Dera) | 49. Gentian Sherif Çekrezi |
| 21. Eralda Petrit Xheli | 50. Admir Taip Lani |
| 22. Mirësi Petrit Xheli | 51. Majlinda Feçor Jezo |
| 23. Ilia Spiro Sena | 52. Klajd Mylazim Sopaj |
| 24. Kozeta Rexhep Alexandrakis (Veiseli) | 53. Marsida Kadri Braja |
| 25. Dylaver Rahman Hysa | 54. Elona Anesti Paul (Mile) |
| 26. Dashamir Luftulla Dauti | 55. Nelda Stavri Reis (Janko) |
| 27. Olsi Asqeri Lleshi | 56. Mirjame Hider Lermen (Hoxha) |
| 28. Luis Anton Bojani | 57. Sokol Thimio Boçi |
| 29. Bledi Lutfi Dervishi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4777, datë 14.2.2006

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE
NË KOMUNËN FAJZA, QARKU KUKËS**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës, si dhe të nenit 14 pika 4 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në njoftimin e Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Fajza, qarku Kukës, të zhvillohen ditën e dielë, datë 19 mars 2006.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4784, datë 19.2.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të neneve 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Aleksandër Sallabanda, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë të Republikës së Shqipërisë në Washington.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 57, datë 1.2.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË PJESE TË
GODINËS SË ISH-ISP-SË, NR.1, NË TIRANË, NGA MINISTERIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TE MINISTERIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pjesës së ndërtesës së ish-ISP-së nr.1, në Tiranë, e cila aktualisht nuk shfrytëzohet, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, për Universitetin Politeknik të Tiranës, të përcaktuar në formularin përkatës të listës së inventarit, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Universitetit Politeknik të Tiranës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve këtë pronë.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit Bashkia Tiranë		Identifikoi: Z.Mynyr Kuçi, specialist inxhinier Supervizor: Znj. Tana Kushova, Drejtore e Burimeve Njerezore&Shërbimeve		Fusha e përdorimit të pronës: Zyrat e ish-Institutit të Studimeve e Projektimeve ujësjellës-ndërtim		Aproveoi: Z.Arben Demeti, Zëvendësministër i MRRTT				
Nr. rendor	Zona kadastr. & indeksit i hartës	A			B			C		
		Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale: sa e ndërtesës (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1		3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Godina e ISPUN	Rruga "Muhamet Gjollështa"	2360	2200	Zyrat e ISPUN	ISPUN	ISPUN	

VENDIM
Nr. 63, datë 1.2.2006

PËR LISTËN E MALLRAVE, TË ZGJEDHURA PËR LLOGARITJEN E INDEKSIT DHE PËRCAKTIMIN E MËNYRËS E TË DATËS SË INDEKSIMIT TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 61 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mallrave dhe shërbimeve, të vlerësuara bazë për nivelin minimal jetik të pensionistëve, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Çdo vit, si pasojë e ndryshimit të indeksit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, të vlerësuara bazë për nivelin minimal jetik të pensionistëve, të indeksohen:

a) Të gjitha llojet e pensioneve të pleqërisë, pensioneve të invaliditetit, pensioneve familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet për vjetërsi shërbimi dhe çdo pension tjetër, i caktuar sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

b) Të gjitha llojet e pensioneve të pleqërisë, pensioneve të invaliditetit, pensioneve familjare, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe çdo pension tjetër, i caktuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

c) Të gjitha llojet e pensioneve të pleqësisë, pensioneve të invaliditetit, pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Indeksohen çdo herë dhe në të njëjtën masë me pensionet e pleqërisë edhe:

a) Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ushtarakëve të Ministrisë së Rendit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror”, ligjit nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe përfitimet sipas ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

b) Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”.

c) Pensionet e invaliditetit dhe shtesat mbi pension, të caktuara sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, si dhe shpërblimi i caktuar sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë”.

ç) Trajtimi i veçantë, i dhënë nga ligji nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

d) Trajtimet e veçanta, të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”.

dh) Trajtimet e veçanta, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficer e nënoficer, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”.

e) Trajtimet e veçanta, të caktuara sipas ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, dhe pensionet familjare, të dhëna sipas ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”.

4. Instituti i Statistikave, çdo muaj, të llogarisë indeksin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilin ia raporton Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Afatet dhe mënyrat e raportimit caktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.

Instituti i Statistikave të llogarisë koeficientin mesatar vjetor të indeksimit për pensionistët.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Statistikave mund të ndryshojnë zërat analitikë të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuara në shportën e pensioneve, si dhe peshën specifike të tyre ndaj totalit, në varësi të zhvillimeve të përgjithshme ekonomike dhe të nivelit të nevojave parësore, sipas stadeve të zhvillimit.

5. Koeficienti mesatar vjetor për indeksimin e pensioneve i njoftohet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Financave, çdo vit, jo më vonë se fundi i muajit mars.

6. Koeficient për indeksimin e pensioneve të jetë koeficienti mesatar faktik, i vërtetuar gjatë vitit të mëparshëm. Koeficienti i indeksimit të pensioneve dhe data e fillimit të zbatimit miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

7. Indeksimi i pensioneve, i shtesave mbi pension dhe i trajtimeve të veçanta të përmendura në këtë vendim, bëhet me të njëjtin koeficient.

8. Në rastet kur ndryshimi i indeksit të çmimeve rezulton negativ, shumta e pensioneve individuale në datën e vlerësimit, njihet e drejtë e fituar dhe nuk bëhet rivlerësim.

9. Efektet financiare të indeksimit të pensioneve, shtesave mbi pension dhe përfitimeve të përmendura në këtë vendim, caktohen çdo vit në buxhetin vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

10. Për efekt të llogaritjes së efekteve financiare të indeksimit, në buxhetin e vitit pasardhës, të zbatohet indeksi mesatar i periudhës korrik të vitit të kaluar, korrik i vitit kur përgatitet projektbuxheti i vitit pasardhës.

11. Data e indeksimit të pensioneve është data 1 maj e çdo viti.

12. Përrjashtimisht për llogaritjen e indeksit të pensioneve, për vitin 2005, të përdoret indeksi i përgjithshëm i inflacionit për këtë vit.

13. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Statistikave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E MALLRAVE DHE E SHËRBIMEVE TË SHPORTËS SË PENSIONISTIT

Zërat kryesorë të shpenzimeve të konsumit	Në % ndaj totalit
Ushqim	62.0
Shpenzime për energji elektrike	5.6
Shpenzime për lëndë djegëse	5.0
Shpenzime telefoni	2.5
Shpenzime për ujë	1.0
Shpenzime për pajisje afatgjatë	0.8
Shpenzime për shëndetin	7.4
Shpenzime për detergjentë, etj.	5.7
Transport	2.0
Kulturë, argëtim	1.2
Duhan, pike alkoolike	3.0
Shërbime	0.3
Veshje	1.8

Artikuj shtëpijakë	0.3
Shpenzime për ceremoni	1.1
Kujdes personal	0.2
Të tjera shpenzime	0.1
Shpenzime gjithsej	100.0

VENDIM
Nr. 64, datë 1.2.2006

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË NJË TRUALLI, KISHËS
ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 3 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë t’i kalohet në pronësi, pa shpërblim, trualli, me sipërfaqe 460 m², që ndodhet në pjesën veriore të pronës së kësaj kishe, në qytetin e Tiranës, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 69, datë 27.1.2006

**PËR MËNYRËN E LLOGARITJES SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË
EFEKTIVAVE, OFICERË DHE NËNOFICERË, LUNDRUES TË NËNDETËSEVE DHE
POLUMBARËVE TË FORCAVE DETARE, NË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, në zbatim të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, personat e interesuar të tërheqin nga drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore dy formularë kërkesë për përfitim, të cilat t’i dorëzojnë në repartin ku kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare apo në Komandën e Forcave Detare, kur reparti është suprimuar.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e trajtimit të veçantë financiar të përgatitet nga komandat e reparteve ushtarake dhe të dërgohet në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila, pasi ta shqyrtojë, ta dërgojë atë në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore të vendbanimit përkatës.

2. Për llogaritjen e trajtimit të veçantë financiar, të merret si bazë paga referuese, e cila përbëhet nga paga bazë për gradë, sipas viteve të shërbimit të ushtarakut aktiv të së njëjtës gradë, në çastin e lindjes së të drejtës për këtë trajtim të veçantë financiar.

Për efekt të llogaritjes së pagës referuese të merret funksioni, grada e fundit si lundruet nënujës.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të cilat për vitin 2005 llogariten në shumën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Ministri i Mbrojtjes dhe Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët dhe dokumentacionin tip për zbatimin e tij.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.1.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 76, datë 8.2.2006

PËR LIRIMIN DHE CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRIVE
HUAMARRËSE, NË ADMINISTRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7/2 e 7/8 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të pesonave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Arben Abazi dhe Znj.Donika Papa lirohen nga detyra e administratorit të shoqërive huamarrëse, në administrim.

2. Z.Ymer Liksala, administrator i shoqërisë huamarrëse, në administrim, “Kamberi”, caktohet, gjithashtu, administrator i shoqërisë huamarrëse “M.Leka”, në administrim.

3. Znj.Daniela Riska, administratore e shoqërisë huamarrëse, në administrim, “Silva”, caktohet, gjithashtu, administratore e shoqërisë huamarrëse “Cenaj&Co”, në administrim.

4. Z.Flamur Laze, administrator i shoqërive huamarrëse, në administrim, “Nahlel”, “Beno”, fondacioni “Populli”, fondacioni “Xhaferi”, “Global Foods”, caktohet, gjithashtu, administrator i shoqërive huamarrëse “Fabiona” dhe “Univers”.

5. Ngarkohen Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 77, datë 8.2.2006

PËR LEJIMIN E INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NDËRMARRJEVE E SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR TË PËRDORIN PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MJETEVE MOTORIKE, PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet buxhetore, për fondet limit, të miratuara në buxhetin e vitit 2006, dhe ndërmarrjet e shoqëritë me kapital shtetëror, për fondet nga të ardhurat e tyre, të lejohen të përdorin procedurën “prokurim i drejtpërdrejtë”, me INSIG, sh.a., për sigurimin e detyrueshëm (TPL) të mjeteve të tyre motorike, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

2. Primi që INSIG sh.a. do të arkëtojë nga institucionet buxhetore dhe ndërmarrjet e shoqëritë me kapital shtetëror, të jetë vlera e primit të pastër, plus vlerën e shpenzimeve administrative.

3. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve buxhetore dhe të ndërmarrjeve e shoqërive me kapital shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 5, datë 3.2.2006

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE DUKAGJINI AL SHA

Në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, pasi shqyrtoi kërkesën e bërë nga shoqëria e sigurimeve “Dukagjini Al” sh.a., Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të emrit të shoqërisë së sigurimeve “Dukagjini Al” sh.a. nga “Dukagjini AL” sh.a në “Eurosig” sh.a.

2. Ky vendim në fuqi më 3.2.2006.

KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera

VENDIM
Nr. 6, datë 3.2.2006

**PËR MIRATIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË RISIGURUESE TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT SIGAL SHA**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe të shkronjave “a” dhe “k” të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, pasi shqyrtoi kërkesën e bërë nga shoqëria e sigurimeve “Sigal” sh.a. Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë ushtrimin e veprimtarisë risiguruese nga shoqëria e sigurimit “Sigal” sh.a.
2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të miratimit, në rast se në të ardhmen do të përkeqësohet gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit nga ushtrimi i kësaj veprimtarie.

Ky vendim hyn në fuqi më 3.2.2006.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE**
Asllan Shera

SHPALLJE KËRKESE PËR ZHVLERËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për zhvlerësim me interes publik të pasurisë “Kantier prodhim material ndërtimi”, Zemblak-Korçë, pronë e shoqërisë “Grand Inert” sh.p.k., Korçë, funksionimi i të cilit përbën rrezik të përhershëm për dëmtimin dhe mosfunksionimin e nënstacionit 400/110 kV Zemblak-Korçë”.

Subjekti kërkues i këtij zhvlerësimi është: “KESH” sh.a. Tiranë.

Me anën e kësaj shpalljeje, kërkojnë të vëmë në dijeni shoqërinë që preket nga ky zhvlerësim.

Vënia në dijeni konsiston në pasurinë që zhvlerësohet dhe masën e kompensimit të vendosur nga Komisioni i Posaçëm i Zhvlerësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas tabelës me të dhënat e mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e shpalljes, subjekti që ka emrin në listën e pronarëve, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij, të shoqëruara me dokumentet përkatëse, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pranë Komisionit të Posaçëm të Zhvlerësimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E TE DHËNAVE, PËR AKTIVITETIN E SHOQËRISË, E CILA ZHVLERËSOHET PËR SHKAK TË FUNKSIONIMIT TË
“NËNSTACIONIT 400/110 KV ZEMBLAK-KORÇË”

RRETHI : KORÇË
KOMUNA: ZEMBLAK

LLOJI I PASURISË QË ZHVLERËSOHET: “KANTIER PRODHIM MATERIAL NDËRTIMI”,
PRONË E SHOQËRISË “GRAND INERT” SHPK KORÇË

Nr.	PËRFAQËSUESI LIGJOR I SHOQËRISË “GRAND INERT”, sh.p.k. KORÇË	AKTIVITETI I SHOQËRISË PASURIA E SË CILËS ZHVLERËSOHET	PËRBËRJA DHE LLOJI I PASURISË QË ZHVLERËSOHET	Numrat e pasurive që zhvlerësohen, pronë e shoq. “Grand Inert” sh.p.k. Korçë, (kantier, prodhim material ndërtimi) Korçë	Zona kadastrale	Vol.	Faqja	Sipërfaqe në m ² , për çdo pasuri	Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa
	SHYQYRI XHENGO (Administratori)	Kantier prodhim material ndërtimi	Tokë arë Truall Truall Truall Truall Ndërtesë Ndërtesë Ndërtesë Ndërtesë	89/41 249/14 249/15 249/16 249/17 249/20 249/21 249/22 248/1	3903 3903 3903 3903 3903 3903 3903 3903 3903	16 15 15 15 15 16 16 16 16	104 225 226 227 228 105 106 107 108	80 617,2 293,5, nga kjo 21 m ² ndërtesë 300,9 182 29 143 12,6 37,5	22.337.074	Zemblak- Korçë
									22.337.074	

(njëzet e dy milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Librazhd me vendimin nr.18, datë 20.1.2006 shpall të vdekur shtetasin Faik Qemal Sanxhaktari.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
- Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit:
04 255 563 ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET (suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT.....	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT.....	2000

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 20.2.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë